



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:068147

Datë: 16.05.2019

Numri i dokumentit: 00315723

P. nr.833/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. A. nga Gjakova ,për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.1704/18 të dt.22.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **08.05.2018**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë - Prokurorit Mone Syla ,te dëmtuarit K. R. , mbrojtësit të akuzuarit av. A. M. dhe të akuzuarit F. A., mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli , ndërsa përpiluar me dt. 10.05.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F. A.**, i biri i A. dhe i nënës M. e gjinisë N. , data e lindjes . . . në Gjakovë , rruga “ . . . , ka te kryer shkollën e mesme ,i gjendjes se mesme ekonomike , menaxher , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i martuar ,atë i 2 fëmijëve ,me ID . . .

Bazuar në nenin 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së:

REFUZOHET AKUZA

Se :

- me dt.11.11.2018, rreth orës 12:56 min., seriozisht e kanos personin tjetër ne atë mënyrë qe i pandehuri F.nga numri i tel. . . . , ne rrjetin social viber i ka dërguar mesazh kërcënues te dëmtuarit duke i thanë se “K. na ke nxjerr telashe ,s’jam ka mundem me e ndal babën ,për riza te zotit ik prej atyhit se e ki honger pasha Allahun , mos na bon keq ik per riza te zotit se është nxehtë shume ,te lutem ik prej atyhit .So ka mundet me ta fal veç qe na ki pre ne besë ,okon duhtë me kallëzu ska pas problem ,tëe lutem s’jam ka mundem me e ndal qato te ka thanë baba ne GJK s’munesh me punu unë gjallë po ta dho besën e zotit qe qetash ki prek aty ku nuk duhet e ik sa me shpejt”, me ç ‘rast te i dëmtuari shkakton frikë dhe ankth.

-me çka do te k ishte kryer veprën penale te kanosjes nga neni 185/1 te KPRK-ës

Shpenzimet e procedurës penale bien ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1704/18 të dt.22.11.2018, e ka akuzuar të akuzuarin F. A. nga Gjakova , për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185/1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Mone Syla , gjate shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 08.05.2019, lexoi aktakuzën PP.nr.1704/18 të dt.22.11.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari F. A. ,duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. A. M. e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, mirëpo qëllimi im nuk ka qene serioz dhe dikush e ka keqpërdor me qene se me te dëmtuarin vazhdimisht kemi pasur raporte te mira me qe i njëjti ka punuar tek ne e edhe sot raportet tona janë te mira , i dëmtuari punon edhe me tutje ne punëtorin ton dhe me te mban familjen e tij.

I dëmtuari K. R. deklaroi se me te akuzuarin nuk kemi pasur nga ajo ditë mosmarrëveshje dhe prap punojë ne punëtorin e te akuzuarit ashtu qe nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi gjegjësisht e tërhiq kallëzimin penal .

Prokurori i shtetit Mone Syla , deklaron me qene se kjo vepër penale duke u bazuar ne dispozitat ligjore te nenit 185/5 ku decidivisht parashihet se procedura penale për veprën penale nga paragrafi 1 dhe 2 fillohet sipas propozimit te dëmtuarit ,atëherë me qene se i dëmtuari është tërhequr nga ndjekja penale dhe kompensimi i demit tërhiqem nga aktakuza kundër te akuzuarit F. A.

Pasi që Prokurori është tërhequr nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit, Gjykata në bazë të nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 454 par. 1 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P. nr. 833/18 të dt. 08.05.2019.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.